

# **Funksioni 6: STREHIMI DHE KOMODITETET E KOMUNITETIT**

## **Programi 06140: Planifikimi Urban Vendor**

### **Përmbajtja**

<b>HYRJE .....</b>	<b>2</b>
<b>1. PËRSHKRIM I PËRGJITHSHËM I PROGRAMIT 06140.....</b>	<b>2</b>
<b>2. QËLLIMET DHE OBJEKTIVAT E POLITIKËS SË PROGRAMIT .....</b>	<b>4</b>
<b>3. PLANI I SHPENZIMEVE TË PRODUKTEVE TË PROGRAMIT .....</b>	<b>6</b>
<b>4. PROJEKTET E INVESTIMEVE TË PROGRAMIT.....</b>	<b>8</b>
<b>5. TË DHËNA MBI PROGRAMIN .....</b>	<b>9</b>
<b>6. PROJEKTET E PLANIFIKUARA PER PBA 2023-2025.....</b>	<b>9</b>

## HYRJE

### 1. Përshkrim i Përgjithshëm i Programit 06140

Vështrim i përgjithshëm		
Planifikimin dhe zhvillimin i banesave të përshtatshme në njësinë vendore. Veprimtari për zhvillimin dhe përmirësimin e jetesës.		
Kodi i programit	Përshkrimi i programit	Përshkrimi i programit
06140	Planifikimi Urban Vendor	<ul style="list-style-type: none"><li>• Zhvillim, përditësim, bashkërendim dhe monitorim i planeve të zhvillimit urbanistik;</li><li>• Planifikim, administrim, zhvillim dhe kontrolli i territorit, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj;</li><li>• Grante, hua ose financime për të mbështetur zgjerimin, përmirësimin ose mirëmbajtjen e stokut të banesave;</li><li>• Lëshimi i lejeve për ndërtime të reja; zhvillimi i tokës dhe veprimtari të tjera që ndikojnë në urbanistikën e njësisë së vetëqeverisjes vendore;</li><li>• Administrim, bashkërendim dhe monitorim i planeve të përgjithshme, planeve, programeve dhe buxheteve të lidhura me strehimin;</li><li>• Shpërndarje e informacionit publik, dokumentacionit teknik dhe statistikave për çështjet dhe shërbimet e strehimit;</li><li>• Sigurimi i truallit të nevojshëm për ndërtime banesash; ndërtim ose blerje dhe rimodelim i njësisë banuese për publikun në përgjithësi ose për njerëz me nevoja të posaçme; eliminim i ndërtimeve të degraduara i lidhur me sigurimin e strehimit;</li><li>• Planifikim i përgjithshëm duke përfshirë formulimin, përditësimin, bashkërendimin dhe monitorimin, të Planeve të Përgjithshme Vendore /Planeve të Zhvillimit Strategjik;</li><li>• Hartimi i planeve të zonimit dhe i rregullave të ndërtimit;</li></ul> <ul style="list-style-type: none"><li>• Hartim, administrim, bashkërendim dhe monitorim i politikave të përgjithshme, planeve, programeve dhe buxheteve që lidhen me shërbimet për komunitetin;</li><li>• Administrim i çështjeve dhe shërbimeve për zhvillimin e komunitetit;</li><li>• Planifikimi i komuniteteve të reja ose i komuniteteve të rehabilituara.</li></ul>

Tabela 1 Shpenzimet e Programit sipas Kategorive ekonomike

**PBA 2023-2025**

PBA 2023-2025								
<b>Raport</b>		<b>Shpenzimet Totale të Programit sipas Kategorive Ekonomike</b>						
<b>Bashkia Shkoder</b>		<b>Institucioni-</b>						
<b>Programi</b>		6140	<b>Planifikimi urban Vendor</b>					
Shpenzimet e Programit (000 ALL)								
Emri i Artikullit	Kodi i Artikullit	2020	2021	2022	2022	2023	2024	2025
		Fakt	Fakt	Buxh. Fillest.	Buxh. Pritshëm	Plani	Plani	Plani
<b>Paga dhe Sigurime</b>								
Paga	600	0	0	0	0	0	0	0
Sigurime Shoqërore & Shëndetësore	601	0	0	0	0	0	0	0
<b>Korente</b>								
Mallra dhe Shërbime	602	0	0	0	0	0	0	0
Subvencion	603	0	0	0	0	0	0	0
Transferta të Brendshme	604	0	0	0	0	0	0	0
Transferta të Jashtme	605	0	0	0	0	0	0	0
Transferta për Familje & Individë	606	0	0	0	0	0	0	0
<b>Shpenzime Kapitale</b>								
Aktive të Paprekshme	230	0	0	500	500	0	0	0
Aktive të Prekshme	231	0	0	1,000	1,000	500	500	500
<b>TOTALI</b>		<b>0</b>	<b>0</b>	<b>1,500</b>	<b>1,500</b>	<b>500</b>	<b>500</b>	<b>500</b>



## Komente

**Programi 06140: Planifikimi urban vendor**, ka si burim financimi të ardhurat. Shpenzimet neto janë shpenzime që mbulojnë nga të ardhurat e programit dhe përdoren vetëm për investime. Për vitet 2023, 2024 dhe 2025 të gjitha shpenzimet janë në trajtën e shpenzimeve kapitale.

## 2. Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit

Tabela 2 Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit

POLITIKA E PROGRAMIT					
Programi Buxhetor Afatmesëm		2023-2025			
Programi	06140	Planifikimi Urban Vendor			
<b>Përshkrimi i Programit</b>					
<ul style="list-style-type: none"><li>• Zhvillim, përditësim, bashkërendim dhe monitorim i planeve të zhvillimit urbanistik;</li><li>• Planifikim, administrim, zhvillim dhe kontrolli i territorit, sipas rënës së përcaktuar me ligj.</li><li>• Grante, hua ose financime për të rmbështetur zgjerimin, përmirësimin ose mirëmbajtjen e stokut të banesave;</li><li>• Lëshimi i lejeve për ndërtime të reja; zhvillimi i tokës dhe veprimtari të tjera që ndikojnë në urbanistikën e njësisë së vetëqeverisjes vendore.</li><li>• Administrim, bashkërendim dhe monitorim i planeve të përgjithshme, planeve, programeve dhe buxheteve të lidhura me strehimin;</li><li>• Shpërndarje e informacionit publik, dokumentacionit teknik dhe statistikave për çështjet dhe shërbimet e strehimit;</li><li>• Sigurimi i truallit të nevojshëm për ndërtim banesash; ndërtim ose blerje dhe rimodelim i njësive banuese për publikun në përgjithësi ose për njerëz me nevoja të posaçme; eliminim i ndërtimeve të degraduara të lidhur me sigurimin e strehimit.</li><li>• Planifikim i përgjithshëm duke përfshirë formulimin, përditësimin, bashkërendimin dhe monitorimin, të Planeve të Përgjithshme Vendore/Planeve të Zhvillimit Strategjik;</li><li>• Hartimi i planeve të zonimit dhe i rregullave të ndërtimit;</li><li>• Hartim, administrim, bashkërendim dhe monitorim i politikave të përgjithshme, planeve, programeve dhe buxheteve që lidhen me shërbimet për komunitetin;</li><li>• Administrimi i çështjeve dhe shërbimeve për zhvillimin e komunitetit;</li><li>• Planifikimi i komuniteteve të reja ose i komuniteteve të rehabilituara</li></ul>					
1	<b>Qëllimi i Politikës së Programit</b>	Strategji të unifikuara për zhvillimin e integruar të territorit në funksion të krijimit të një rajoni shumëqendëresh përmes krijimit e zhvillimit të infrastrukturës publike, administrative, sociale dhe kulturore.			
Treguesit e Performancës në nivel Qëllimi		<b>2022</b>	<b>2023</b>	<b>2024</b>	<b>2025</b>
		<b>Buxheti</b>	<b>Plani</b>	<b>Plani</b>	<b>Plani</b>

	Bashkia përdor instrumentat planifikimit sipas parashikimeve ligjore :Instrumentat të përdorur nga bashkia: - PPV periudha 2015 - 2030	1	1	1	1
	Bashkia përdor instrumentat planifikimit sipas parashikimeve ligjore : Plani detajuar për njësi të ndryshme	8	9	7	7
<b>1.1.</b>	<b>Objektivi i Politikës së Programit</b>	Hartimi, mbështetja dhe monitorimi i proceseve planifikuese në Bashkinë Shkodër, me qëllim sigurimin e kornizës së përgjithshme të zhvillimit të territorit dhe promovimit të tij.			
Treguesit e Performancës për Objektivin					
	Bashkia përdor instrumentat planifikimit sipas parashikimeve ligjore :Instrumentat të përdorur nga bashkia: - PPV periudha 2015 - 2030	1	1	1	1
	Bashkia përdor instrumentat planifikimit sipas parashikimeve ligjore : Plani detajuar për njësi të ndryshme	8	9	7	7
	Bashkia akordon leje zhvillimi mbi bazën e planeve të detajuara vendore: Numri lejeve të miratuara	55	60	65	70
	Efiçienca e programit të planifikimit urban vendor: Raporti i të ardhurave nga lejet e zhvillimit të miratuara kundrejt totalit të të ardhurave të bashkisë (në %).	14%	16%	16%	16%
<b>1.2.</b>	<b>Objektivi i Politikës së Programit</b>	Realizimi dhe Monitorimi i Sistemit të Adresave si mjet për përmirësimin e shërbimeve dhe identitetit të qytetarit			
Treguesit e Performancës për Objektivin					
	Përmirësimi i adresarit të bashkisë Shkodër: Rritja e rrugëve të azhurnuar në sistemin e adresave në vite (ndryshimi vjetor në %)	14%	14%	12%	112%
<b>Kryetari i NJQV</b>		<b>Koordinatori i GMS</b>		<b>Drejtuesi i Programit</b>	
Emri Mbiemri	Bardh Spahia	Emri Mbiemri	Tonin Dedaj	Emri Mbiemri	Aljon Koçkiçi
Nënshkrimi		Nënshkrimi		Nënshkrimi	
Datë:		Datë:		Datë:	

### 3. Plani i Shpenzimeve të Produkteve të Programit

Tabela 3 Planet e Shpenzimeve të Produkteve të Programit

<b>SHPENZIMET E PRODUKTEVE TË PROGRAMIT</b>				
<b>Programi Buxhetor Afatmesëm</b>		<b>2023-2025</b>		
<b>Programi</b>	<b>06140</b>	<b>Planifikimi Urban Vendor</b>		
<b>1.1.</b>	<b>Objektivi i Politikës së Programit</b>	Hartimi, mbështetja dhe monitorimi i proceseve planifikuese në Bashkinë Shkodër, me qëllim sigurimin e kornizës së përgjithshme të zhvillimit të territorit dhe promovimit të tij.		
<b>1.1.A.</b>	<b>Produkti</b>	Plan i detajuar Vendor		
	<i>Kodi i Projektit</i>	P06140.Q1.O1.A1		
	Përshkrimi i Produktit:	hartimi i planeve të detajuara vendore		
	Njësia Matëse	numër		
		<b>2022</b>	<b>2023</b>	<b>2024</b>
		<b>Buxheti</b>	<b>Plani</b>	<b>Plani</b>
	Sasia	8	9	7
	Kosto totale (në mijë lekë)	0	0	0
	Kosto për njësi (në mijë lekë)	0.0	0.0	0.0
	Ndryshimi në % i Sasisë		12.5%	-22.2%
	Ndryshimi në % i koston totale		#DIV/0!	#DIV/0!
	Ndryshimi në % i koston për njësi		#DIV/0!	#DIV/0!
<b>1.1.B.</b>	<b>Produkti</b>	Numri i lejeve të ndertimit		
	<i>Kodi i Projektit</i>	P06140.Q1.O1.A3		
	Përshkrimi i Produktit:	Miratimi i lejeve të ndertimit / zhvillimit në zbatim të PPV dhe PDV		
	Njësia Matëse	numër		
		<b>2022</b>	<b>2023</b>	<b>2024</b>
		<b>Buxheti</b>	<b>Plani</b>	<b>Plani</b>
	Sasia	55	60	65
	Kosto totale (në mijë lekë)			
	Kosto për njësi (në mijë lekë)	0.0	0.0	0.0
	Ndryshimi në % i Sasisë		9.1%	8.3%
	Ndryshimi në % i koston totale		#DIV/0!	#DIV/0!
	Ndryshimi në % i koston për njësi		#DIV/0!	#DIV/0!
<b>1.2.</b>	<b>Objektivi i Politikës së Programit</b>	<b>Realizimi dhe Monitorimi i Sistemit të Adresave si mjet për përmirësimin e shërbimeve dhe identitetit të qytetarit</b>		
<b>1.2.B.</b>	<b>Produkti</b>	Adresari i Bashkisë Shkodër		
	<i>Kodi i Projektit</i>	P06140.Q1.O2.A1.		

Përshkrimi i Produktit:	Numer tabela per azhormimi, ndryshimi, emertimi I rrugeve apo shesheve apo ndertesa			
Njësia Matëse	Numer tabela			
	<b>2022</b>	<b>2023</b>	<b>2024</b>	<b>2025</b>
	<b>Buxheti</b>	<b>Plani</b>	<b>Plani</b>	<b>Plani</b>
Sasia	1,000	1,000	1,000	1,000
Kosto totale (në mijë lekë)	500	500	500	500
Kosto për njësi (në mijë lekë)	0.5	0.5	0.5	0.5
Ndryshimi në % i Sasisë		0.0%	0.0%	0.0%
Ndryshimi në % i kostos totale		0.0%	0.0%	0.0%
Ndryshimi në % i kostos për njësi		0.0%	0.0%	0.0%

  

<b>Kryetari i NJQV</b>		<b>Koordinatori i GMS</b>		<b>Drejtuesi i Programit</b>	
Emri Mbiemri	Bardh Spahia	Emri Mbiemri	Tonin Dedaj	Emri Mbiemri	Aljon Koçkiçi
Nënshkrimi		Nënshkrimi		Nënshkrimi	
Datë:		Datë:		Datë:	

## 4. Projektet e Investimeve të Programit

Tabela 4 Projektet e Investimeve të Programit

PBA 2023-2025  
(000 ALL)

### Projektet e Investimeve

<b>Bashkia Shkoder</b>	<b>Institucioni -</b>	
<b>Programi</b>	6140	<b>Planifikimi urban Vendor</b>

Kodi Projektit	Emri i Projektit	Kosto Totale e Projektit	Burimi i Financimit	Data Fillimit	Data Përfund.	2020	2021	2022	2023	2024	2025
						Fakti	Fakti	Buxheti	Plani	Plani	Plani
1410784	Projektim, rivlerësimi, realizimi dhe monitorimi i Sistemit të Adresave Bashkia Shkodër		Fondet e veta	2021	2022			1,500			
	Rivlerësimi, realizimi dhe monitorimi i Sistemit të Adresave Bashkia Shkodër		Fondet e veta						500	500	500
	<b>Totali</b>	<b>0</b>				<b>0</b>	<b>0</b>	<b>1,500</b>	<b>500</b>	<b>500</b>	<b>500</b>



## 5. Të Dhëna mbi Programin

Tabela 5 Të dhënat e Programit

<b>Të Dhëna Bazë mbi Programin</b>						
	Të Përgjithshme	2018	2019	2020	2021	2022
<b>Të dhënat e programit/ Vitet</b>						
Instrumentat e planifikimit që përdor bashkia:			10	8	8	9
<i>PPV periudha 2015 - 2030</i>			1	1	1	1
<i>Plani detajuar për njësi të ndryshme</i>			9	7	7	8
Numri i lejeve të miratuara në numër		95	45	37	50	55
Taksa e ndikimit në infrastrukturë në mijë lekë		99,431	69,003	69,673	65,687	121,044
Të ardhurat totale të bashkisë në mijë lekë		702,144	680,643	659,084	738,101	856,346
Numër tabela për azhornimin, ndryshimin, emërtimi i rrugëve apo shesheve apo ndërtesa (në numër)						1,000

## 6. Projektet e planifikuara per PBA 2023-2025

Tabela 6 Emertimet e aktiviteve

<b>Projekte të planifikuara</b>			<i>000/lekë</i>
<b>Kodi i projektit/Emërtimi i Aktivitetit</b>	<b>Buxheti 2023</b>	<b>Buxheti 2024</b>	<b>Buxheti 2025</b>
P06140.Q1.O1.A1. Përgatitja e PDV për zonat e parashikuara në PPV.	-	-	-
P06140.Q1.O1.A2. Publikimi i Planeve të Detajuara Vendore nëpërmjet publikimit elektronik dhe mjeteve tradicionale të informimit.	-	-	-
P06140.Q1.O1.A3. Miratimi i lejeve të ndërtimit/ zhvillimit në zbatim të PPV dhe PDV	-	-	-
P06140.Q1.O2.A1. Rivlerësimi, realizimi dhe monitorimi i Sistemit të Adresave Bashkia Shkodër.	500	500	500
<b>Totali</b>	<b>500</b>	<b>500</b>	<b>500</b>

**1.Përgatitja e PDV për zonat e parashikuara në PPV.**

**Kodi në matricë P06140.Q1.O1.A1**

**01. Personat e Kontaktit**

<b>Emri i propozuesit të projektit</b>	Bashkia e Shkodrës	<b>Firma e propozuesit të Projektit</b>	
<b>Të dhëna të detajuara për propozuesin e projektit</b>	Drejtoria Studimeve, Planifikimit dhe Koordinimit të Investimeve		
<b>Institucion Buxhetor/ Ministria/grupi/sektori</b>	Bashkia Shkodrës	<b>Vendodhja e Projektit</b>	Bashkia Shkodër

**02. Identifikimi i Idesë së Investimit**

<b>Projekt Ideja</b>	Përgatitja e PDV për zonat e parashikuara në PPV dhe Rishikimi i Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Shkodër me Procedurë të Thjeshtuar	Viti 2023-2025
<b>Problemet për tu adresuar</b>	<p>Pas hartimit të PPV Shkodër, në mënyrë që të promovohet zhvillimi dhe të ndërtohet duhen hartuar dhe një sërë planesh të përgjithshme vendore. Politika e Bashkisë është që zonat prioritare të zhvillohen me anë të planeve të detajuara vendore në mënyrë që të garantohet një zhvillim sa më i harmonizuar i territorit. PDV do të hartohen nga stafi i bashkisë si dhe me kontraktim. Gjithashtu, pjesë e kontributit për hartimin e PDV do të vijë në marrëveshje edhe me zhvilluesit apo palë të tjera të interesuara bazuar në dispozitat ligjore në fuqi.</p> <p>Parashikohen një sërë PDV të rëndësishme si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Velipojë</li> <li>- Rrjoll</li> <li>- Qendër Shkodër</li> <li>- Shirokë-Zogaj</li> <li>- Zona Industriale</li> </ul> <p>Gjatë periudhës disavjeçare të zbatimit të Planit të Përgjithshëm Vendor miratuar me Vendimin Nr.5 Datë 16.10.2017 të Këshillit Kombëtar të Territorit, autoriteti përgjegjës i planifikimit pranë bashkisë është hasur me disa vështirësi në rregulloren e planifikimit dhe ka lindur nevoja për ndryshime të cilat përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Ndryshimi i sipërfaqeve të disa njësive strukturore të mëdha ku është parashikuar PDV, duke i ndarë këto njësi në sipërfaqe më të vogla.</li> <li>- Korrigjime të lapsuseve apo gabimeve të mundshme si mospërputhja numrit të kateve me lartësisë në metra sipas përcaktimeve të VKM nr. 408 datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së Zhvillimit të Territorit" ( i ndryshuar)</li> <li>- Ndryshim të kufijve të Njësive Strukturore apo kushteve të zhvillimit (nr. katesh, lartësi, KSHT, intensitet ndërtimi, etj.)</li> <li>- Ndryshimi i kufijve administrativë e territorial të Bashkisë Shkodër sipas VKM Nr. 360, datë 29.5.2019: "Për miratimin e hartës së përditësuar të kufijve administrativë territorialë të njësive të vetëqeverisjes vendore"</li> <li>- Heqja e kushtit të hartimit të dokumentit të Planit të Detajuar Vendor, për ato njësi për të cilat është konstatuar si kusht i panevojshëm</li> <li>- Ndryshime ose shtesa në nene të Rregullores së Planit të Zhvillimit të Territorit dhe Rregullores së planifikimit të Territorit që kanë ndryshuar gjatë këtyre 2 viteve.</li> </ul>	
<b>Emri i Programit</b>	Planifikimi urban	
<b>Qëllimet dhe objektivat e programit të cilat projekti do të ndihmojë të arrihen</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Hartimi i Planeve të Detajuara Vendore</li> <li>- Rishikimi i Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Shkodër me Procedurë të Thjeshtuar</li> <li>- Harmonizim dhe koordinim</li> <li>- Zhvillim në bazë njësie</li> </ul>	

**03. Autorizuesit / Hapat e aprovimit të projekt idesë**

	Emri	Nënshkrimi	Data	Qëllimi i rishikimit <i>Statusi i Projektit Idesë</i>
<b>Drejtuesi i Programit në Institucionin Buxhetor (IB)</b>	Drejtorja Studimeve, Planifikimit dhe Koordinimit të Investimeve			
<b>Komente nga Drejtuesi i Programit (nqs ka)</b>				
<b>Sekretari i Përgjithshëm</b>				Konfirmimi/refuzimi i aprovimit të projekt idesë
<b>Komente nga Sekretari i Përgjithshëm (nqs ka)</b>				

**2.Publikimi i Planeve të Detajuara Vendore nëpërmjet publikimit elektronik dhe mjeteve tradicionale të informimit.**

Kodi në matricë: P06140.Q1.O1.A2

**01. Personat e Kontaktit**

<b>Emri i propozuesit të projektit</b>	Bashkia e Shkodrës	<b>Firma e propozuesit të Projektit</b>	
<b>Të dhëna të detajuara për propozuesin e projektit</b>	Drejtoria Studimeve, Planifikimit dhe Koordinimit të Investimeve		
<b>Institucioni Buxhetor/ Ministria/grupi/sektori</b>	Bashkia Shkodrës	<b>Vendodhja e Projektit</b>	Bashkia Shkodër

**02. Identifikimi i Idesësë Investimit**

<b>Projekt Ideja</b>	Publikimi i Planeve të Detajuara Vendore dhe Dokumentit të Rishikuar të Planit të Përgjithshëm Vendor nëpërmjet publikimit elektronik dhe mjeteve tradicionale të informimit.	Viti 2023-2025
<b>Problemet për t'u adresuar</b>	<p>Sipas përcaktimeve të Planit të Përgjithshëm Vendor, njësitë për të cilat do të hartohen plane të detajuara vendore janë SH010.UB, SH012.UB, SH017.UB, SH018.UB, SH019.UB, SH021.UB, SH025.UB, SH026.UB, SH027.UB, SH028.UB, SH029.UB, SH100.UB, SH103.UB, SH104.UB, SH105.UB, SH106.UB, SH108.UB, SH109.UB, SH110.UB, VL007.N, SH003.UB, SH004.UB, SH005.UB, SH006.UB, SH007.UB, SH008.UB, SH009.UB, SH015.UB, SH016.UB, SH041.UB, SH056.UB, SH057.UB, SH111.UB, SH112.UB, SH114.UB, VL002.UB, VL003.UB, VL004.UB, VL005.UB, VL006.UB, VL012.UB, VL013.UB, VL135.UB, VL137.UB. PDV-të kanë për qëllim, sipas rastit, të detajojnë përcaktimet e PPV-së, për: zhvillimin dhe/ose rihvillimin e një njësie; rigjenerimin/ripërtëritjen urbane; përdorimet e tokës dhe kushtet e zhvillimit; investimet publike në infrastrukturë apo shërbimet publike, që ndikojnë në ndryshimin ose rishpërndarjen e kushteve të zhvillimit; programet e drejtimit të zhvillimit nëpërmjet instrumenteve,</p> <p>Fillimi i procesit të punës për hartimin e PDV-së bëhet nga njësia vendore, me iniciativë të veten nisur nga interesi publik për pajisje me infrastrukturë dhe shërbime apo me kërkesë të çdo pale të interesuar për zhvillim. Hartimi i dokumentit të PDV-së kryhet nga vetë autoriteti vendor për planifikimin dhe/ose nga pala e interesuar dhe në çdo rast procesi mbikëqyret në çdo hap nga struktura përgjegjëse e planifikimit të territorit të autoritetit vendor.</p> <p>Me nisjen e procesit të hartimit të PDV-së për secilën njësi strukturore, do të kryhet edhe këshillimi i PDV-së në të gjitha fazat, përmes botimit të dokumentit në regjistër, informimit të palëve të interesuara dhe publikut nëpërmjet një a më shumë mjeteve tradicionale të informimit dhe përmes organizimit të takimeve publike me ta.</p> <p>Gjatë Rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Shkodër dhe hartimit të dokumentit të planifikimit është tepër e rëndësishme të sigurohet një proces dialogu, bashkëpunimi dhe bashkërendimi ndërmjet autoriteteve vendimmarrëse dhe komunitetit, me synim trajtimin e çështjeve dhe pengesave të hasura gjatë periudhës 2-vjeçare të zbatimit të Planit të Përgjithshëm Vendor.</p> <p>Në këtë kuadër, autoriteti përgjegjës i planifikimit pranë Bashkisë parashikon të organizojë 1 seancë këshillimi dhe takimi publik me grupet e interesit të cilat bëhen subjekt i ndryshimeve të dokumentit të planit. Grupi i punës për rishikimin e dokumentit të planifikimit, gjithashtu do të konsultojë dhe rishikojë çdo kërkesë të ardhur pranë Bashkisë. Takimet këshilluese zhvillohen me grupet e interesit dhe ekspertë të fushës, si edhe, me forumet këshillimore vendore. Takimet këshillimore kanë në fokus tërheqjen e mendimeve dhe sugjerimeve nga grupet e specializuara ose që preken drejtpërdrejt nga dokumenti i planifikimit.</p> <p>Rezultatet, komentet dhe propozimet e takimeve publike do të reflektohen dhe do t'i bashkëlidhen dokumentit të planifikimit.</p>	

<b>Emri i Programit</b>	Planifikimi urban
<b>Qëllimet dhe objektivat e programit të cilat projekti do të ndihmojë të arrihen</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Publikimi i PDV</li> <li>- Këshillimi i PDV</li> <li>- Publikimi i Dokumentit të Rishikuar PPV</li> <li>- Këshillimi i Rishikimit të PPV</li> <li>- Harmonizim dhe koordinim</li> <li>- Zhvillim në bazë njësie</li> </ul>

**03. Autorizuesit / Hapat e aprovimit të projekt idesë**

	Emri	Nënshkrimi	Data	Qëllimi i rishikimit <i>Statusi i Projekt Idesë</i>
<b>Drejtuesi i Programit në Institucionin Buxhetor (IB)</b>	Drejtorja Studimeve, Planifikimit dhe Koordinimit të Investimeve			
<b>Komente nga Drejtuesi i Programit (nqs ka)</b>				
<b>Sekretari i Përgjithshëm</b>				Konfirmimi/refuzimi i aprovimit të projekt idesë
<b>Komente nga Sekretari i Përgjithshëm (nqs ka)</b>				

#### 4.Rivlerësimi, Realizimi dhe Monitorimi i Sistemit të Adresave Bashkia Shkodër

Kodi në matricë P06140.Q1.O2.A1

##### 01. Personat e Kontaktit

<b>Emri i propozuesit të projektit</b>	Bashkia Shkodër	<b>Firma e propozuesit të Projektit</b>	
<b>Të dhënat e detajuara për propozuesin e projektit</b>	Drejtoria Studimeve, Planifikimit dhe Koordinimit të Investimeve		
<b>Institucioni Buxhetor / Ministria/grupi/sektori</b>	Bashkia Shkodër	<b>Vendodhja e Projektit</b>	Bashkia Shkodër

##### 02. Identifikimi i Idesë se Investimit

<b>Projekt Ideja</b>	
<b>Problemet për tu adresuar</b>	<p>Në kuadër të ndryshimit të kufinjve administrativ të bashkisë, sistemet e adresave të Nj.A janë të pa integruar në mënyrë që të funksionojnë si një i vetëm. Kjo problematikë i bën jo funksional sistemet ekzistuese.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Qyteti Shkodër, Nj A Velipojë, Nj A Rrethina, Nj A Ana e Malit, Nj A Guri i Zi, Nj A Dajç ka sistem adresash të miratuar, pjesa e mbetur e komunave nuk disponon sistem adresash të miratuar.</li> <li>- Për qytetin dhe njësitë e përmendura, është realizuar azhurnimi i objekteve të reja të ndërtuara në vitet e fundit.</li> <li>- Bashkia Shkodër aktualisht po përditëson sistemin hartografik elektronik të informacionit bazuar mbi verifikimin në territor.</li> </ul>
<b>Emri i Programit</b>	Planifikimi Urban
<b>Qëllimet dhe objektivat e programit të cilat projekti do të ndihmojë të arrihen</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1.Mbledhja e të dhënave të gjëndjes ekzistuese të tyre në gjithë territorin</li> <li>2. Rivlersimi i sistemeve të adresave ekzistuese</li> <li>3.Mirëmbajtja dhe azhurnimi i sistemit të adresave</li> <li>4.F.V. e tabelave të rrugëve të emërtuara rishtazi</li> </ol>

##### 0.3. Kostot e Projektit të Investimit

	Viti 2023	Viti 2024	Viti 2025
<b>Kosto</b>	<b>500</b>	<b>500</b>	<b>500</b>

##### 04. Autorizuesit / Hapat e aprovimit të projekt idesë

	Emri	Nënshkrimi	Data	Qëllimi i rishikimit <i>Statusi i Projekt Idesë</i>
<b>Drejtuesi i Programit në Institucionin Buxhetor (IB)</b>	Drejtoria Studimeve, Planifikimit dhe Koordinimit të Investimeve			
<b>Komente nga Drejtuesi i Programit (nqs ka)</b>				
<b>Sekretari i Përgjithshëm</b>				Konfirmimi/refuzimi i aprovimit të projekt idesë
<b>Komente nga Sekretari i Përgjithshëm (nqs ka)</b>				